

Departamenti Amerikan i Punës

Gjetjet mbi Format më të Rënda të Punësimit të Fëmijëve gjatë vitit 2023

Shqipëria

Gjatë vitit 2023, Shqipëria bëri një përparim të moderuar në përpjekjet për të eliminuar format më të rënda të punësimit të fëmijëve. Qeveria publikoi Strategjinë e saj të parë për Mbrojtjen e Viktimave 2024–2030 për të forcuar mekanizmat e mbrojtjes dhe shërbimet sociale për të mbijetuarit e formave më të rënda të punës së fëmijës, duke përbushur kështu një nga detyrimet e saj si një vend kandidat i Bashkimit Europian. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve vazhdoi gjithashtu t'u ofrojë punonjësve të mbrojtjes së fëmijës, ofruesve të shërbimeve sociale qeveritare dhe palëve të tjera të interesuara trajnime të rregullta dhe plane për menaxhimin e rasteve për pjesën më të pambrojtur të fëmijëve. Po kështu, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit bashkëpunoi me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët për të adoptuar Skemën Kombëtare të Garancisë për Rininë nga tri bashkitë e mëdha për të ofruar trajnime profesionale dhe edukim shtesë për fëmijët dhe të rinjtë ekonomikisht të pambrojtur. Agjencia Kombëtare e Rinisë ofroi gjithashtu mbështetje për qendrat e reja rinore, të cilat ofrojnë burime edukative dhe trajnime të aftësive digjitale për të rinjtë në rrezik. Megjithatë, korniza ligjore e Shqipërisë, që rregullon punësimin e fëmijëve, nuk ndalon në mënyrë të qartë shfrytëzimin, prokurimin ose ofrimin e fëmijëve në veprimtari të paligjshme. Për më tepër, fëmijët nga komunitetet e pakicave rome dhe egjiptiane ballkanike, fëmijët me aftësi të kufizuara, refugjatët dhe fëmijët emigrantë të zhvendosur përballen me pengesa të konsiderueshme për të pasur qasje në arsimin në vend.

Veprimet e sugjeruara më poshtë për qeverinë do të mbyllnin boshllëqet që Departamenti Amerikan i Punës ka identifikuar në zbatimin nga ana e Shqipërisë të angazhimeve të saj ndërkombëtare për eliminimin e formave më të rënda të punës së fëmijëve.

Fusha	Sugjerime për Veprim
Kuadri Ligjor	Të ndalohet penalisht shfrytëzimi, prokurimi dhe ofrimi i fëmijëve nën moshën 18 vjeç në aktivitete të paligjshme, përfshirë këtu edhe në prodhimin dhe trafikimin e drogës.
	c
Zbatimi	Të lejohen inspektorët e punës të inspektojnë sektorin informal, ku dihet se punësohen fëmijët, përfshirë shtëpitë private, fermat private ose bizneset e pargjistruara.
Koordinimi	Të rritet koordinimi midis Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale, dhe Policisë së Shtetit.
Programet Sociale	Të mblidhen dhe publikohen të dhëna gjithëpërfshirëse mbi shtrirjen dhe natyrën e punës së fëmijëve në Shqipëri. Në veçanti, të grumbullohen të dhëna mbi shtrirjen dhe

Fusha**Sugjerime për Veprim**

kushtet e punës së fëmijëve në sektorë me shqetësim të lartë, si sektorët e bujqësisë dhe ndërtimit, në mbështetje të programeve sociale.

Të sigurohen burime të përshtatshme transporti për të gjithë fëmijët që përballen me pengesa lidhur me transportin për ndjekjen e shkollës, veçanërisht për fëmijët romë dhe egjiptianë ballkanikë dhe ata që jetojnë në komunitete larg shkollave.

Të shtohen përpjekjet për të eliminuar pengesat dhe për ta bërë arsimin të disponueshëm për të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët nga komunitetet e pakicës romë dhe egjiptiane ballkanike, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nga Siria, Afganistani, Bangladeshi dhe vende të tjera, që jetojnë në Shqipëri si refugjatë ose emigrantë të zhvendosur, duke hequr të gjitha tarifat në lidhje me shkollimin dhe të sigurohet që fëmijët pa dokumentacion të mos përballen me pengesa për t'u regjistruar në shkollë.

Të ofrohen shërbime përkthimi për të gjithë fëmijët, veçanërisht për ata nga familje refugjatësh dhe emigrantësh, që hasin pengesa gjuhësore në lidhje me arsimimin e tyre.

Të rritet numri i strehimoreve për viktimat e formave më të rënda të punës së fëmijëve, në veçanti, për fëmijët e pastrehë që jetojnë dhe punojnë në rrethet e lypjes së detyruar në rrugë.

Të krijohen programe në ndihmë të fëmijëve, viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore.

Të rriten fondet dhe burimet njerëzore për programet sociale për punën e fëmijëve dhe të ndahen si duhet fondet sociale të centralizuara për bashkitë, në mënyrë që programet të zbatohen ashtu siç duhet.